



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të :

AC-I-16-0128-A0001

A0001 S.M. Gjilan

Ankuesi

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Agim Ramadani 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Mr. Sc. Sahit Sylejmani dhe Sabri Halili, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCEL-11-0065 i datës 13 maj 2016, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 19/09/2019 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

-I- Ankesa e ankuesit A0001 S.M., aprovohet si e bazuar.

-II- Ndryshohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS , SCEL-11-0065 i datës 13 maj 2016 dhe i njëjti përfshihet ne listën e punëtorëve legjitim, përfitues të 20 % nga privatizimi i NSH-së.

-III- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike

Ndërmarrja Shoqërore "I" në Gjilan, është privatizuar me datë 02 mars 2006.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar me datë 11 dhe 12 nëntor 2011 në gazetën ditore në gjuhën shqipe ndërsa me datë 10 dhe 11 nëntor në gjuhën serbe si dhe në tirazhin e fundjavës më 12 dhe 13 nëntor 2011, afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS, kundër Listës përfundimtare ka qene data 03 dhjetor 2011.

Ndaj listës përfundimtare të AKP-së për punëtorët e kualifikuar, përfitues të 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH "I" në Gjilan, ne DHPGJS ka parashtruar ankesë S.M..

Më 13 maj 2016 Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin SCEL-11-0065 me të cilin:

1. Padia refuzohet
2. Ankuesi është përgjegjës për shpenzimet e procedurës. Për këtë procedurë nuk ka taksa gjyqësore për t'u paguar.

Kolegji i Specializuar sa i përket refuzimit të padisë ka arsyetuar se ankesa është e pranueshme dhe pse ishte parashtruar me vonesë pasi që ankuesi ka pohuar se afatin e ka humbur për shkak se ka qenë në trajtim mjekësor dhe se nuk ishte në gjendje që ta dorëzonte ankesën në kohë, të cilat pretendime Kolegji i Specializuar i mori si të bazuara, ndërsa sa i përket besueshmërisë së padisë Kolegji i Specializuar ka konstatuar se ankuesi nuk ishte në listën e pagave të kompanisë në

kohën e privatizimit dhe ankuesi vet e ka vërtetuar se kjo nuk kishte ndodhur për shkak të diskriminimit sikurse punëtorët e tjerë, por se nuk kishte punë në fabrikë.

Me datë 09 qershor 2016 **Ankuesi A0001 S.M.**, ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit SCEL-11-0065 të datës 13 maj 2016 për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së ligjit në fuqi mbi refuzimin e paraqitësve të kërkesave duke i propozuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme që anulohet aktvendimi i shkalles së parë dhe rasti të kthehet në rigjykim. Ankuesi ka pohuar se ka filluar të punoj në NSH që nga viti 1990 deri në vitin 1999, e cila fabrikë ishte shitur në vitin 2006, ai pohon se nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës edhe pse fabrika nuk ishte në funksion. Sipas ankuesi gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që ankuesi ishte punëtor në NSH për një kohë të gjatë dhe si i tillë ka të drejtë në çdo gjë që i përket punonjësve të tjerë, po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë në trajtim mjekësor dhe se nuk ka mundur të angazhohet për çështjen e tij përveç informimit përmes gazetave.

AKP-ja ankesën e ankuesit të lartcekur e ka pranuar me datë 17 qershor 2016 dhe ndaj të njëjtës nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit A0001 S.M. aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Ankuesi A0001 S.M., i lindur më 23/11/1968 ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit SCEL-11-0065 të datës 13 maj 2016. Ankuesi ka pohuar se ka filluar të punoj në NSH që nga viti 1990 deri në vitin 1999, librezë e punës është e hapur

herën e fundit më 05/06/1996 dhe nuk është mbyllur. Fabrika ishte shitur në vitin 2006, ai pohon se nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës edhe se fabrika nuk ishte në funksion. Sipas ankuesit gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që ankuesi ishte punëtor i NSH-së për një kohë të gjatë dhe si i tillë ka të drejtë në çdo gjë që i përket punonjësve të tjerë, po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë në trajtim mjekësor dhe se nuk ka mundur të angazhohet për çështjen e tij përveç informimit përmes gazetave

AKP-ja ka parashtruar përgjigje duke propozuar që ankesa të hedhet poshtë si e pa pranueshme për shkak se është parashtruar pas afatit kohor.

Kolegji i Apelit vlerëson se refuzimi i ankesës nga ana e Kolegjit të Specializuar nuk është i drejtë.

Nga shkresat e lëndës Kolegji i Apelit vie në përfundim se nuk është kontestuese se ankuesi ishte punëtor i NSH-së, Kolegjit të Apelit ky ankues nuk i plotëson kriteret nga neni 10.4 i rregullores së UNMIK-ut për tu përfshirë në listën përfundimtare pasi që ka dëshmuar se ai ka qenë punëtor në NSH. Ankuesi edhe vet ka pohuar se ka punuar në NSH deri në vitin 1999, dhe se për shkak të trajtimit mjekësor nuk ka mundur të paraqitet në punë libereza e punës e hapur.

Andaj Kolegji i Apelit nga këto fakte nuk pajtohet me përfundimin e Kolegjit të Specializuar dhe vlerëson se ankuesi ka paraqitur ndonjë dëshmi relevante se i njëjti në kohën e privatizimit të NSH-së do të mund të kishte qenë në listë të pagave të ndërmarrjes, kritere që kërkohen të plotësohen nga neni 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, me qëllim që ankuesit ti njihet e drejta për tu futur në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime në 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH "I", Gjilan.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor duhet të priset dhe i njëjti të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime në 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH "I", Gjilan.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Lidhur me listat e punëtorëve, Dhoma e Posaçme nuk cakton taksat gjyqësore, konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 19/09/2019

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues _____

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim (përfshirë përkthimin e tij në gjuhën Serbe) tek:

- Ankuesi
-
- Ankuesit në shkallë të parë

- Tek e paditura

- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën SCEL-11-0065-C-02584

Ilmi Bajrami, Kryesuesi i Kolegjit të Apelit